



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Ministria e Mbrojtjes
Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve

Nr. 19550/11 prot.

Datë 05.12.11

Nr. 7690 prot.

Datë 5/12/2011

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Mbi

Bashkëpunimin për kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (në vijim DPD)

nën varësinë e Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë,
e përfaqësuar nga z. Flamur GJYMISHKA, Drejtor i Përgjithshëm,

dhe

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (në vijim AKSHE)

nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë,
i përfaqësuar nga z. Erald DERVISHI, Kryetar i Autoritetit,

- duke vlerësuar të domosdoshëm bashkëpunimin ndërinstitucional në kontrollin e transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë;
- në funksion të sigurimit të interesave kombëtare të Republikës së Shqipërisë, mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, zbatimit të misionit mbrojtës të Shërbimit Doganor
- mbështetur në Nenin 79 e në vijim të Kodit Civil, nenet 11 dhe 295 të ligjit Nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për nënshkrimin e këtij Memorandumi, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, palët vendosën të hartojnë dhe nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi, me përfaqësim në nivelin e titullarit të institucionit (Drejtor i Përgjithshëm / Kryetar), me përmbajtje sa më poshtë vijon:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Fusha e veprimtimit

Ky Memorandum Mirëkuptimi,

1.) Siguron lehtësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi dhe kryerjen e veprimtarive të bashkëpunimit e bashkërendimit ndërmjet palëve për kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

2.) Zbatohet për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë që eksportohen, importohen apo tranzitohen nëpër territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, lidhur me procedurat doganore që kanë të bëjnë me kontrollin shtetëror të import - eksportit, si dhe kontrollin doganor të dokumentave dhe identifikimit të mallrave. Meqënëse këto procedura do të aplikohen në mënyrë plotësuese kërkohet një bashkëpunim më i ngushtë midis palëve, ku:

a) Autoritetet Doganore ushtrojnë kontroll fizik dhe dokumentar mbi të gjitha transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë sipas legjislacionit doganor në fuqi;

b) Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve gëzon të drejtën e inspektimit mbi të gjitha transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë sipas legjislacionit në fuqi.

3.) Duke konsideruar të nevojshëm dhe shumë të rëndësishëm kontrollin mbi këto mallra, palët angazhohen për implementimin brenda një kohe sa më të shkurtër të listës së harmonizuar të kodeve të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë dhe kodeve tarifore doganore sipas Nomenklatures së Kombinuar të Mallrave, në sistemin informatik të doganes.

Neni 2 Përkufizime

1.) "Transferim ndërkombëtar i mallrave", është eksportimi, importimi, riekportimi i mallrave, lëvizja e përkohshme e tyre, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kalimi transit i mallrave përmes territorit të saj dhe ndonjë transfertë tjetër mallrash jashtë këtij territori, në të cilën janë përfshirë subjekte të ndryshme.

2.) Mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë janë ato mallra, lista e të cilave miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, të përditësuar në zbatim të ligjit nr.9707, datë 05.04.2007, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import - eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë".

Neni 3 Baza ligjore

– Ligji nr. 9707, datë 05.04.2007, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë";

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 16.01.2008, "Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 09.02.2011 "Për miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve";
- Akte të tjera në fushën e veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake, mallrave dhe teknologjive, me përdorim të dyfishtë;
- Ligji Nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", i ndryshuar;

Neni 4

Lista e mallrave - fusha e kontrolleve

- 1.) Kontrolli i transferimeve ndërkombëtare shtrihet mbi të gjitha mallrat që janë pjesë e listës së mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë të miratuara me VKM, të përditësuara në mënyrë vjetore dhe që dalin në zbatim të ligjit nr.9707, datë 5.4.2007, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë".
- 2.) Mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë edhe gjatë importit, eksportit, kalimit transit, për qëllime jotregtare dhe që mbahen nga udhëtarët në sasi të vogla, janë objekt licensimi nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe kontrollohen nga Shërbimi Doganor.
- 3.) Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve është përgjegjës për përditësimin e listave të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjitë me përdorim të dyfishtë, duke informuar në kohë Autoritetet Doganore për të gjitha ndryshimet në të;

II. PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 5

Shtrirja e bashkëpunimit

- 1.) Bashkëpunimi midis palëve do të jetë i ndërsjelltë në ndihmën e ofruar njëri-tjetrit, në kompetencat që zotërojnë në kryerjen e detyrave, si dhe në fusha të tjera të cilat janë të lidhura me kontrollin e mallrave ushtarake e mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë.
- 2.) Palët në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me objektin e punës kanë autoritetin e plotë për të bashkëpunuar në fushat e mëposhtme:
 - a.) Në harmonizimin e punës dhe përmirësimin e bashkëpunimit në të gjitha nivelet;
 - b.) Kryerjen e veprimeve të përbashkëta dhe aktiviteteve të tjera;
 - c.) Analizën e riskut të përbashkët;
 - d.) Shkëmbimin dhe mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe komunikimin elektronik.
 - e.) Përmirësimin e qarkullimit të mallrave strategjike në kufi

- f.) Bashkëpunimin me organet e tjera shtetërore dhe bashkëpunimin ndërkombëtar;
- g.) Dhënien e ekspertëve dhe të asistencës teknike;
- h.) Realizimin e trajnimeve të përbashkëta;

III. FORMA E BASHKËPUNIMIT

Neni 6.

Harmonizimi i punës dhe përmirësimi i bashkëpunimit

Me qëllim për të përmirësuar efikasitetin e punës dhe për të rritur bashkëpunimin dhe marrëdhëniet në nivel qendror, rajonal dhe lokal, Palët në Memorandum koordinojnë midis tyre aktivitetet në varësi të kompetencave që zotërojnë.

Neni 7.

Veprimet e përbashkëta

1.) Palët në këtë Memorandum do të planifikojnë dhe do të kryejnë veprime të përbashkëta në fushën e zbatimit e përditësimit të kuadrit ligjor, për shkëmbimin e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave, për analizë të përbashkët risku, për kontrole të përbashkëta në PKK, për trajnime të personelit të tyre, si brenda vendit, ashtu dhe në aktivitete ndërkombëtare.

Neni 8.

Analizë e përbashkët risku

1.) Palët në këtë Memorandum do të bashkëpunojnë në fushën e analizës së përbashkët të riskut, me objektiv minimizimin e rreziqeve në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, përfshirë edhe parandalimin e trafikut të tyre;

2.) Në funksion të sa më sipër, bazuar në treguesit statistikorë dhe analitikë, si dhe në përputhje me gjëndjen e përgjithshme të kontrollit kufitar, ekspertë të të dy Palëve do të takohen në mënyrë periodike dhe do të diskutojnë gjëndjen dhe nevojën për masa përmirësuese, bazuar në një analizë të përbashkët të riskut. Takimet periodike do të kryhen jo më pak se dy herë në vit, pa përfshirë këtu takime të tjera për çështje të veçanta.

Neni 9.

Ekspertët dhe asistenca teknike

1.) Me qëllim përmirësimit e efikasitetit, operimit dhe racionalitetit në kryerjen e detyrave të tyre, si dhe detyrave të paleve që janë me interes të përbashkët, dhe në veprime të përbashkëta në zona të tjera të bashkëpunimit, palët në MM do të ofrojnë ekspertët e nevojshëm dhe asistencë teknike.

2.) Në rast nevojë, si dhe me qëllim kryerjen e detyrave zyrtare, Palët në MM do të ofrojnë pajisje teknike dhe të tjera për përdorim, nëse kjo nuk pengon kryerjen e detyrave të rregullta të Palëve të MM të cilat ofrojnë pajisjet.

3.) Palët në MM mund të prokurojnë pajisjet teknike për përdorimin e përbashkët.

Neni 10.
Trajnimi dhe përmirësimi

- 1.) AKSHE bashkëpunon në fushën e trajnimit dhe të përmirësimit të kontrollit doganor, duke dorëzuar paraprakisht plane dhe programe për trajnimin dhe përmirësimin e njohurive të personelit doganor.
- 2.) AKSHE ofron seminare dhe trajnime, si dhe shkëmbimin e lektorëve;
- 3.) Ekspertë Trajnimi të AKSHE për fusha të ndryshme të veprimit në çështjet e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, do të jenë në dispozicion për trajnim të nëpunësve të doganave.

Neni 11.
Bashkëpunimi me organet e tjera

- 1.) Palët në MM në kryerjen e detyrave të tyre dhe aktiviteteve të përbashkëta, gjithashtu bashkëpunojnë me organet e tjera të administratës shtetërore, si dhe me personat juridikë në lidhje me trafikun kufitar;
- 2.) Palët në MM veprojnë në një mënyrë të koordinuar në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- 3.) Në qoftë se është e nevojshme, Palët në MM mund të përfshijnë në forma individuale të bashkëpunimit organe të tjera sipas paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 12.
Shkëmbimi i të dhënave

- 1.) Palët në MM duhet të sigurojnë mbrojtje efektive të të dhënave që shkëmbejnë, veçanërisht për të dhënat personale, në mënyrë që të parandalojnë hyrjen, ndryshimin apo lëshimin e paautorizuar të të dhënave personale.
- 2.) Duke respektuar kushtet dhe mënyrën e nivelit të duhur të disponueshmërisë të përcaktuar në dispozitat e rregulloreve të veçanta të cilat janë për mbrojtjen e të dhënave, shkëmbimi i të dhënave mund të kryhet me **LINK**, me akses të drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, në të dhënat e mbledhura që administrohen nga Palët.

IV. PROCEDURAT NË PIKAT DOGANORE

Neni 13.
Procedurat në Pikat e Kalimit Kufitar të autorizuara

- 1.) Punonjesi doganor duhet të pranojë regjimin doganor vetëm në rastet kur subjekti plotëson të gjithë dokumentacionin e duhur dhe paraqet licensën apo autorizimin origjinal, si dhe kopje të noterizuar për praktikën doganore përkatëse;
- 2.) Në rastet e eksportit, importit, tranzitit të mallrave, të cilat janë objekt i këtij Memorandumi, Shërbimi Doganor duhet të kryejë kontroll të vecantë;
- 3.) Në rast të ndonjë parregullsie në dokumentacion, në gjëndjen fizike, në identifikimin e mallit, apo

dyshimi të arsyetuar, punonjesi doganor duhet të kontaktojë personat e kontaktit në AKSHE, të përcaktuar në Aneksin "Personat e Kontaktit";

4.) Në rastin kur importuesi apo agjenti i autorizuar doganor i paraqet punonjësit doganor një dokument tranziti për mallra, të cilat bëjnë pjesë në listat e mallrave ushtarake ose mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, punonjesi doganor kontrollon dhe sigurohet që të ketë dokumente të rregullta shoqëruese të ngarkesës, në mënyrë të veçantë licencat perkatese për transferim nderkombëtar;

5.) Në rastin kur në pikat kufitare paraqitet një ngarkesë dhe punonjesi doganor ka një dyshim të arsyetuar se mallrat mund të bëjnë pjesë në listat e mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, atëherë mund të kërkojë të konsultohet e mbështetet me ekspertizë nga AKSHE nepermjet personave të kontaktit.

6) Pas përfundimit të procedurës nga Zyra Doganore në Pikën e Kalimit Kufitar, mjetet e transportit vazhdojnë udhëtimin për në Zyrat doganore në brendësi të territorit;

7.) Në rastet e ngarkesave të ndaluara nga Shërbimi Doganor për mungesa në dokumentacion apo shkelje të tjera, çlirimi i mallit nuk mund të bëhet pa u plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi. Në këtë proces, Shërbimi Doganor mund të konsultohet e mbështetet me ekspertizë nga AKSHE.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14.

Koordinimi dhe raportimi

1.) Palët në MM në të gjitha nivelet organizative (drejtues dhe teknik) do të emërojnë koordinatore bashkëpunimi dhe do të këmbëjnë të dhënat e tyre të kontaktit (numrin e telefonit, faksit, e-mail).

2.) Koordinatorët e Bashkëpunimit të organizojnë takime në niveleve respektive të paktën një herë në çdo tre muaj, ku të analizohen rezultatet e bashkëpunimit, të dhënat e shkëmbimit dhe të ndërmerren veprime të koordinuara për të gjitha çështjet të cilat janë me interes të përbashkët.

3.) Koordinatorët e bashkëpunimit paraqesin për palët në MM raporte periodike mbi punën e tyre.

4.) Palët në Memorandum informohen në mënyrë të ndërsjelltë për të gjitha çështjet e rëndësishme të implementimit të këtij Memorandumi dhe inkurajojnë zbatimin e këtij MM.

Neni 15.

Zbatimi i Shtojcave e Anekseve

Palët në këtë Memorandum mund të përfshijnë Shtojca dhe Anekse për forma specifike të bashkëpunimit dhe sidomos për shkëmbimin e të dhënave, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e këtij Memorandumi Mirekuptimi.

Neni 16.

Ndryshimet në Memorandum

1.) Memorandumi hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë dispozitë e tij nuk

është në tejkalim ose kundërshtim të akteve përkatëse ligjore e nënligjore, mbi të cilat palët ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

2.) Palët, kur gjykohet e arsyeshme dhe duke rënë dakort paraprakisht midis tyre, mund të ndryshojnë ose shtojnë dispozita të këtij Memorandumi si dhe çdo Shtojcë apo Aneks të tij.

Neni 17. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 1.) Mosmarrëveshjet në zbatimin e këtij Memorandumi zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet Palëve.
- 2.) Memorandumi është i vlefshëm derisa palët të mos kenë kërkuar me shkrim shfuqizimin e tij.
- 3.) Kur mosmarrëveshja nuk zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, ajo u parashtrohet Ministrave respektivë për diskutim e zgjidhje.

Neni 18. Publikimi

- 1.) Ky Memorandum nuk do të publikohet në Fletoren Zyrtare. Ai do të jetë dokument në përdorim të strukturave të të dy institucioneve nënshkruese, në nivelet e përcaktuara respektivisht nga drejtuesit më të lartë;
- 2.) Ky Memorandum mund t'ju bëhet i njohur partnerëve ndërkombëtarë të institucioneve nënshkruese, përfshirë programet e asistencës teknike dhe ato të zhvillimit.

Neni 19. Hyrja në fuqi

- 1.) Ky Memorandum hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e e Palëve.
- 2.) Memorandumi i Bashkëpunimit përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje; 2 (dy) për Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe 2 (dy) për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

**Për
Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave**

DREJTOR I PERGJITHSHEM



**Për
Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve**

